

## STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT

Në bazë të Legjislacionit Shqiptar, Ligiin Nr. 9901, datë 14.04.2008 Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" i ndryshuar si dhe Ligjit Nr. 9723 dt 03.05.2007 "Për Regjistrimin e Biznesit" i ndryshuar, une Denata Dudushi shtetase shqiptare, lindur më 16/05/1975 në Tiranë identifikuar me kartë identiteti nr.034416754 dhe nr. Personal H55516066A, me zotësi të plotë juridike për të vepruar,shpall si më poshtë vijon:

Sot, më datë **21.06.2024** (njëzet e katër) në Tiranë krijimin e shoqërisë tregtare me përgjegjësi te kufizuar.

### KAPITULLI I EMRI I SHOQËRISË- SELIA- KOHËZGJATJA-OBJEKTI

#### Neni 1

##### Emri

- 1.1 Shoqëria do të quhet **Tobacco Corner** (Këtu e më poshtë "Shoqëria")
- 1.2 Shoqëria do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.

#### Neni 2

##### Selia

Selia e shoqërisë do të jetë tek Arena Center, Sheshi Italia 1, Tiranë.

#### Neni 3

##### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është pa afat.

#### Neni 4

##### Objekti

4.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

Tregëti me pakicë të produkteve te ndryshme ushqimore, përfshire pije freskuese dhe alkalike, cigare dhe aksesore te ndryshëm.Tregëti e pergjithshme e cigareve, import-eksport me shumicë dhe me pakicë.Perpunimi i nenprodukteve te duhan si shisha, paketimi dhe ambalazhimi i tyre, Shitja e nenprodukteve te ambalazhuar, importi-exporti dhe shitja e pajisjeve per konsumin e nenprodukteve te duhanit. Tregti te llojeve te ndryshme me pakice e shumice, si edhe import - eksport, te tilla si:- Mallra industrial, ushqimore, lende te para, pije, veshmbathje e konfeksione, hidro-sanitare, hidraulike, kancelari per shkolla dhe zyra, orendi shtepiake, mobilje, pajisje elektrike.e elektronike industriale dhe shtepiake, produce bujqesore e blektorale, fruta perime, produkte deti, bime medicinale, eterovajore e mjeksore, produkte kozmetike dhe estetike, parfumeri, kimikate e detergjente;- Aktivitet tregtare ne ushqimin social; - Hoteleri Turizem, bar - kafe e restorante;- Organizim evente , aktivitete prodhuese ose perpunuese ne fusha te ndryshme te bujqesise dhe industrise se lehte dhe ushqimore, te erzave dhe aromave te ndryshme.te shijeve per shisha etj. Prodhimin c produkteve te duhanit (shije per shisha).



**KAPITULLI II**  
**KAPITALI THEMELTAR**  
**NENI 5**  
**Kapitali Themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 1,000 lekë (njëmijë lekë) i përbërë nga 1 kuote Znj. Denata Dudushi zotëron 100 % të kapitalit të shoqërisë në vlerë 1000 lekë (njemije lekë). Kuota e Pjesëmarrësve në kapital janë të gjitha të emëruara dhe të pa ndashme. Kapitali është terësisht i shlyeshëm dhe i nënshkrueshëm. Çdo kuotë i takon e drejta e një vote.

**NENI 6**

Shoqëria drejtohet dhe administrohet nga organet e saj të cilat janë:

1. Asambleja e përgjithshme
2. Administratori

Ortaku që ka ndërmend të shesi kuotat e tij tërësisht, apo pjesërisht duhet më parë të njoftojë ortakët e tjerë të shoqërisë. Ortaku tjetër ka të drejtën e blerjes së parë. Këtë të drejta ortaku duhet ta ushtrojë brenda 30 ditëve nga dita e njoftimit.

Në rastin e mos ushtrimit të së drejtes së blerjes së parë, ortaku që do të shesë kuotat duhet të njoftojë emrin e blerësit dhe kushtet, të cilat nuk duhet të jene me të favorshme se sa ato të afuara ortaku tjetër të shoqërisë.

**NENI 7**

Kuotat e kapitalit janë të pasqyruara dhe të regjistruara në librat e llogarisë të shoqërisë.

**NENI 8**

Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakëve në proporcion me përqindjen e kapitalit të investuar, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortakët nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar në ligj.

**NENI 9**

Shoqëria tregtare " **Tobacco Corner** " sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, material ose jo material, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurive se vet tek të tjerët.

**NENI 10**


Shoqëria tregtare " **Tobacco Corner** " sh.p.k. vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët themelues të shoqërisë, mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kuotave të kapitalit të investuar në të. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet që ortakët kanë pasur para se ajo të krijohet.

**KAPITULLI I III**  
**DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**NENI 11**

**Kompetencat e ortakut**

**11.1** Ka të drejtë të administrojë aktivitetin e shoqërisë, konform objektit të veprimtarisë së saj, duke përfshirë edhe veprimtarinë prodhuese e tregtuese që Shoqëria mund të kryejë, vlerat e saj intelektuale e ekonomike-financiare. Kane të drejtë të marrin dijëni për rezultatet ekonomiko



financiare në çdo fazë të aktivitetit të saj. Kane të drejte të marrin pjese vetë ose me anë të përfaqësuesve në këtë aktivitet.

11.2 Kanë të drejtë të tërheqin të gjitha dokumentet kryesore të shoqërisë për tre vitet e fundit.

11.3 Kane të drejtë të heqin dorë nga shoqëria dhe mund të shesin pjesën e kapitalit të tyre në përputhje me kushtet që i lejon statuti dhe ligji.

11.4 Ortakët në përputhje me statutin e aktin e themelimit dhe legjislacionin në fuqi kanë, të drejtë që në të njëjtën kohë të jenë ortakë edhe në shoqëri të tjera.

11.5 Ortakët rezervojnë të gjitha të drejtat sipas ligjit Tregtar.

## NENI 12

### Administrimi i shoqërisë

12.1 Ortaku i vetëm apo Asambleja e Përgjithshme emëron një person fizik si administrator të shoqërisë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë rimerimi.

12.2 Emërimi i administratorit jep efekte ligjore vetëm pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.

12.3 Administratori ka të gjitha të drejtat dhe fuqitë për drejtimin e zakonshëm të shoqërisë, me qëllim që të arrijë objektivat e saj, përveç atyre që ligji ia atribuon ortakëve.

12.4 Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakut, ka të drejtë të veprojë, firmosi pranë çdo organi administrativ, banke të nivelit të dytë dhe ku të shikohet e arsyeshme për të ushtruar aktivitetin e shoqërisë.

12.5 Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj znj. Denata Dudushi me afat 5 vjeçar.

## NENI 13

### Detyrat e Administratorit/ëve

Administratori i shoqërisë ka dhe këto detyra dhe të drejta:

- Të lidhë marrëveshje me të tretët brenda objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe kompetencave të caktuara nga ortakët.
- Të zbatojë rregullat e brendshme të shoqërisë.
- Të paguhet për punën e kryer në baze të marrëveshjes së bërë midis tij dhe ortakëve.
- Të marrë të dhëna e të bëjë propozime mbi gjithçka që ai e quan të dobishme për shoqërinë.
- Të miratojë planet e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre dhe të paraqesë ato sipas rastit për miratimin përfundimtar nga ortakët.
- Të propozojë ortakëve për krijimin e njesive strukturave të ndryshme si filial, dege e përfaqësi në qytetet të tjera të vendit ose jashtë shtetit.
- Të përgatise propozimin për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe t'ia paraqesë asamblesës së ortakëve për miratim. Të përzgjedhë ekspertin kontabël dhe anëtarë të komisionit të likuidimit si dhe të paraqesë propozimet për miratim para ortakëve.
- Të sigurojë zbatimin e përpikë të Vendimeve të Ortakëve.
- Të kryejë çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ortakët e shoqërisë.

## KREU III MAREDHENIET E PUNES

**KREU III**  
**MAREDHENIET E PUNES**  
**NENI 14**

Marrëdhëniet e punës ne shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave te punës. Për çështjet qe kjo kontrate nuk i parashikon zbatohen dispozitat përkatëse te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

**NENI 15**

Për çdo mos marrëveshje qe mund te lind midis palëve dhe qe nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e rrethit Gjyqësor Tirane.

**NENI 16**

**Sekreti i punës**

Te gjithë të punësuarit ne shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë. Kjo detyre vazhdon edhe pas largimit te tyre nga shoqëria.

**KAPITULLI I IV**  
**VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT**

**NENI 17**

**Viti financiar**

Vitit financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

Përfundimisht Viti i parë financiar përfshin kohen nga data e regjistrimit te shoqërisë ne regjistrin tregtar dhe përfundon me 31 Dhjetor te atij viti.

**NENI 18**

**Inventari dhe llogarite vjetore.**

Shoqëria do te mbaje një kontabilitet te rregullt te pasurisë dhe te veprimtarisë se saj ne pajtim me kërkesat ligjore

Ne mbylljen e vitit financiar administratori harton inventarin e pasurisë ne ketë datë dhe llogaritë vjetore për vitin financiar.

**NENI 19**

**Raportet vjetore**

**19.1** Ne mbylljen e çdo viti financiar administratori dhe/ose eksperti harton inventarët dhe llogarite vjetore ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortaket.


**19.2** Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjate vitit financiar te kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.

**19.3** Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël/ kontabilisti i miratuar te autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga ortaket sipas Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare".

**NENI 20**

**Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme.**

**20.1** Nga fitimi i realizuar gjate vitit financiar pasi zbriten humbet e vitit te mëparshëm, hiqet menjane një shume e barabarte me 5 % (pese perqind) e fitimit e destinuar për formimin e fondit rezerve te quajtur "rezerve e domosdoshme".



**20.2** Heqja nga fitimi për rezervën e domosdoshme pushon se qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin 10% të kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur për një arsye çfarëdo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 10% e kapitalit.

**20.3** Ortaket mund të vendosin edhe zbritje të veçante në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

#### **NENI 21**

Te ardhurat eventualisht të ndjekura nga shoqëria çdo vit financiar janë të destinuara siç është vendosur nga ortaket duke i qëndruar në uljen 5% që do të destinohet rezervës ligjore.

### **KAPITULLI V MBYLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI**

#### **NENI 22**

Veprimtaria e shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentable gjatë dy vjetëve të fundit radhazi dhe kur për këtë vendos gjykata kompetente.

#### **NENI 23**

**23.1** Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortaket caktojnë një likuiditor, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emërtimit dhe emrin "Shoqëri në Likuidim e sipër".

**23.2** Likuiditori i emëruar nga ortaket menjëherë sapo merr detyrën është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia venë në dispozicion menjëherë ortakeve.

**23.3** Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

#### **NENI 24**

**24.1** Ortaket vendosin mbi rregullshmerine e likuidimit, për të vendosur për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuiditorit.

**24.2** Ortaket mund të vendosin vete realizimin e kesaj mbledhje, në rast se likuiditori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakeve ose të një mandatmbajtësi të caktuar prej tij.

#### **NENI 25**

**25.1** Kur ortaket për shkaqe të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likuidimit.

**25.2** Aktet e mbylljes dhe likuidimit e depozitimit të dokumentacionit në regjistrin tregtar Shoqëria c' regjistrohet prej tij.

### **DISPOZITET KALIMTARE**

#### **NENI 26**

##### **Dispozitat e fundit**

**26.1** Për të gjitha ceshtjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

**26.2** Për efekt të inteprentimit të këtij Statuti me Ligj Tregtar nenkuptohet Ligji nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare"

**26.3** Pavlefshmëria eventuale të dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të cenojnë vlefshmërinë e tij.



**NENI 27**

**Gjykata kompetente**

Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarveshjeve dhe intepretimin e Statutit te Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

**NENI 28**

**Hyrja në fuqi**


Ky Statut dhe Akt themelimi hyn në fuqi dhe është i detyrueshëm për zbatim në momentin e firmosjes nga Ortakët.

**ORTAKU THEMELUES I SHOQERISE**

**“Tobacco Corner” sh.p.k.**

**Denata Dudushi**

*Denata Dudushi*

A stylized handwritten signature consisting of a circle with a vertical line through it and a horizontal line extending to the right.